

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6894
E shtunë, 13 maj 2023
Çmimi 0.40 €

Kosova, përfituese e Programit të BE-së "Tregu i Përbashkët" me vlerë 4.2 miliardë euro

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

POWERI: PROCESI I NORMALIZIMIT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË DUHET TË ÇOJË NË NJOHJE TË NDËRSJELLË

FAQE 3



Administratoresha e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Samantha Power, ka theksuar në Prishtinë se procesi i normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë

duhet të çojë në njohje të ndërsjellë. Edhe pse palët ende nuk kanë qëndrime të përbashkëta se cili do të jetë modaliteti i asociacionit, Poweri ka thënë se është e rëndësishme

tani që idetë janë paraqitur. "Të arrihet kompromisi në mënyrë që të mund të vazhdojë normalizimi i cili do të çojë përfundimisht në njohjen përfundimtare, njohjen e ndërsjellë", ka deklaruar Poweri

KURTI: KOSOVA MERITON STATUSIN E KANDIDATIT PËR ANËTARËSIM NË BE

FAQE 4



WEBERI: PA KTHIMIN E SERBËVE NË INSTITUCIONE S'MUND TË KETË ZBATIM TË MARRËVESHJEVE

FAQE 5

RITJA E NORMAVE BANKARE, GODITJE PËR SEKTORIN PRIVAT

F. 8

FALSIFIKIM I PARASË, POLICIA NJOFTON PËR PESË RASTE TË REJA

F. 8

SPORT



DUKA, THIRRJE ATYRE QË PËR INATE PERSONALE PENGOJNË FFK-në: HIQNI DORË NGA KJO SJELLJE

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kërcënohet kryeministri kroat

ZAGREB, 12 MAJ - Kryeministri kroat Andrej Plenković u konfirmoi gazetarëve në Dubrovnik se më 12 maj është marrë një kërcënim telefonik ndaj tij personalisht dhe anëtarëve të Qeverisë së Kroacisë dhe se njësi për intervenim e policisë po siguron ndërtesën e qeverisë në sheshin Markova të Zagrebit.

Ky kërcënim ndaj kryeministrit dhe qeverisë përkon me raportin e Shërbimit Informativ të Sigurisë - SOA lidhur me situatën e sigurisë në Kroaci në vitin e kaluar, i cili u publikua më 12 maj. "Dhe tani ka një kërcënim, njësi për intervenim e policisë është aktualisht para Qeverisë sepse sot në mëngjes ka pasur një kërcënim të atij lloji ndaj meje dhe anëtarëve të Qeverisë", tha Plenković në një deklaratë për mediet në Dubrovnik. "Kjo ndodh gjatë gjithë kohës dhe ne duhet të punojmë për të shtypur grupet e

tilla, duke angazhuar të gjitha shërbimet që merren me këtë çështje", shtoi ai.

Kryeministri kroat tha se për këtë arsye "SOA e publikoi këtë raport dhe t'i japim fund kësaj". "Kroacia është vend demokratik, ku respektohet sundimi i ligjit, institucionet dhe rendi kushtetues. Dhe është e sigurt se ata që duan të rrëzojnë pushtetin me mjete të dhunshme, nuk do të kalojnë pa u vënë re dhe shteti dhe institucionet e tij do të veprojnë. Ata punojnë gjatë gjithë kohës", tha Plenković.

Kërcënimet e zbuluara të 'individëve me pikëpamje ekstremiste'

SOA thekson se "zbuloi përpjekje të individëve me qëndrime ekstremiste dhe militante për të organizuar pasuesit e tyre në

mënyrë paraushtarake, me qëllim të zbatimit të trajnimit ushtarak dhe blerjes së armëve, si dhe me qëllimin përfundimtar të përmbyesjes së rendit kushtetues demokratik".

Plenkovići tha në Dubrovnik se "ishin dy grupe të identifikuara shumë qartë, të cilat ndërlihdnin një rreth njerëzish, me qëllim të përmbyesjes së dhunshme të rendit kushtetues".

Ai rikujtoi se para tre vjetësh Danijell Bezuk shkoi në ndërtesën e qeverisë, i armatosur me kallashnikov dhe filloi të qëllonte dhe në këtë rast u plagos rëndë polici Oskar Fiuri. "Keni pasur një sulm terrorist nga Bezuk, para tre vjetësh, në Banske Dvori, jo domosdo për të plagosur policin Oskar Fiuri, por për të kryer një akt terrorist kundër Qeverisë, do të thotë, kundër kryeministrit, kundër meje. Për këtë nuk ka asnjë dilemë", shtoi kryeministri kroat.



Plenkovići vlerësoi se "ai i ri e ka bërë këtë për shkak të atmosferës dhe ambientit, në të cilin është rritur". "Dikush i dha armën, dikush e mësoi të shtinte, dikush e nxiti atë që të kishte atë moment vullneti që është më i

rëndësishmi. Ishim me fat që nuk ia arriti qëllimit", tha kryeministri. Sulmi ndodhi më 12 tetor të vitit 2020. I riu 22-vjeçar më pas kreu vetëvrasje në një pyll aty afër, ndërkaq Prokuroria e Shtetit e cilësoi aktin e tij si terrorizëm.

Turqia raporton për përparim në marrëveshjen për grurin e Ukrainës

ANKARA, 12 MAJ - Turqia njoftoi të premten se bisedimet që po zhvillohen në Stamboll për ta rinovuar marrëveshjen që lejon eksportet e grurit të Ukrainës nëpërmjet Detit të Zi pas pushtimit të Rosisë, po rezultojnë me sukses.

Marrëveshja, e cila mundëson eksportin e sigurt të grurit ukrainas, përfundon më 18 maj, ndërkohë Moskë ka kërcënuar të tërhiqet nëse kërkesat e saj nuk plotësohen. "Ne po shkojmë drejt pajtueshmërisë për vazhdimin e marrëveshjes për grurin", tha ministri turk i Mbrojtjes, Hulusi Akar, nëpërmjet një deklaratë për



shtyp.

Akar iu referua bisedimeve në Stamboll këtë javë ndërmjet zyrtarëve nga Turqia, Rusia, Ukraina dhe Kombet e

Bashkuara.

Përfaqësuesit e Ukrainës, Rosisë, Turqisë dhe Kombeve të Bashkuara (OKB) u takuan në Stamboll, më 11 maj lidhur me

propozimet e OKB-së për të zgjeruar iniciativën për transportin e grurit përmes Detit të Zi.

Përveç vazhdimin të marrëveshjes, takimi në Stamboll u fokusua në një propozim të Kombeve të Bashkuara për të rifilluar eksportet e amoniakut të Rosisë përgjatë tubacionit Togliatti-Odesa, tha Organizata e Kombeve të Bashkuara nëpërmjet një njoftimi.

OKB-ja dhe Turqia ndërmjetësuan për marrëveshje, në korrik të vitit 2022, për të lehtësuar krizën globale të ushqimit, e cila u

shkaktua nga pushtimi rus i Ukrainës. Marrëveshja ndihmoi që ushqimi të arrijë te njerëzit në vendet më të varfra në Afrikë, Lindje të Mesme dhe Azi.

Rusia kishte publikuar një listë kërkesash në lidhje me eksportet e saj bujqësore, të cilat dëshiron të përmbyshen para se ajo të pajtohet për zgjatje të marrëveshjes.

Ndërsa eksportet e tilla ruse nuk i nënshtrohen sanksioneve perëndimore të vendosura pas pushtimit të Ukrainës, në shkurt të vitit 2022, Moskë thotë se kufizimet e pagesave, logjistikës dhe sigurimeve po i pengojnë dërgesat.

Vazhdon beteja për Bahmutin, Moskë mihon përparimet e Ukrainës

BAHMUT, 12 MAJ - Luftime të ashpra midis forcave ukrainase dhe ruse po vazhdojnë në Bahmut, qyteti i Donjeckut që ka qenë fokusi kryesor i ofensivës së Moskës në rajonin e Donbasit, përderisa raportohet se Kievi ka fituar në zona të caktuara të frontit, ndërsa vendi përgatitet për një kundërsulm të shumëpritur.

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Ukrainës raportoi se në 24 orët e fundit, forcat ukrainase u mbrojtën me sukses kundër 44 sulmeve ruse në Bahmut, ndërsa vija e frontit Bahmut-Avdivka-Marinkavazhdon të bombardohet rëndë nga forcat

ruse.

Më 11 maj u raportua për përparime të Ukrainës në rajone të ndryshme, duke përfshirë Bahmutin, por Rusia shpejtoi t'i mohonte ato. Mohimet qarkulluan nga blogerët ushtarakë pro-Moskës dhe Yevgeni Prigozhin, kreu i grupit mercenar Wagner që ka luajtur një rol kyç në betejën për Donjeckun.

Ministria ruse e Mbrojtjes deklaroi se "situata në zonën e operacionit special ushtarak ishte nën kontroll".

Zëdhënësi i Kremlinit Dmitry Peskov gjithashtu u përpoq të qëndronte optimist, duke thënë se "operacioni special ushtarak"



kundër Ukrainës kishte qenë sfidues, por këmbënguli se disa

qëllime ishin arritur. Prigozhin pretendoi më 11 maj

se kundërofensiva e Ukrainës ishte tashmë duke u zhvilluar.

Në zonën e Bahmutit, tha ai, forcat e armatosura ukrainase "po godasin krahët tanë dhe, për fat të keq, në disa vende ato janë të suksesshme".

Presidenti Volodymyr Zelensky hodhi poshtë raportimet, duke thënë në një intervistë me transmetuesit evropianë se Kievi po vonon fillimin e kundërofensivës sepse i mungojnë armët perëndimore për të pasur sukses pa pësuar shumë viktima.

Zelensky tha se është e mundur që "ne mund të shkojmë përpara dhe të jemi të suksesshëm".

Poweri: Procesi i normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të çojë në njohje të ndërsjellë

Administratorja e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Samantha Power, ka theksuar në Prishtinë se procesi i normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të çojë në njohje të ndërsjellë. Edhe pse palët ende nuk kanë qëndrime të përbashkëta se cili do të jetë modaliteti i asociacionit, Power ka thënë se është e rëndësishme tani që idetë janë paraqitur. “Të arrihet kompromisi në mënyrë që të mund të vazhdojë normalizimi i cili do të çojë përfundimisht në njohjen përfundimtare, njohjen e ndërsjellë”, ka deklaruar Power

EPOKA
ERE

Lirim GECI

Prishtinë, 12 maj - Administratorja e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Samantha Power, ka thënë se është e qartë se krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë është një hap thelbësor që duhet të ndërmerret për ta siguruar vazhdimin e procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që duhet të përmbyllet me njohje të ndërsjellë.

Poweru i bëri këto komente në një fshat afër komunës së Gjilanit, rreth 45 kilometra në lindje të Prishtinës, në ditën e parë të vizitës së saj në Kosovë. “Marrëveshja është aty, ka urgjencë për shembull për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe shpresojmë që tani, më në fund, dialogu ka një rrugë se si do të duket. Edhe pse palët ende nuk

kanë qëndrime të përbashkëta se cili do të jetë modaliteti, kjo është hera e parë që po ndodh ky lloj i angazhimit thelbësor”, tha Power, duke nënvizuar se themelimi i Asociacionit është diçka që zyrtarët në Serbi e konsiderojnë shumë të rëndësishme. “Prandaj është e rëndësishme tani që idetë janë paraqitur, të arrihet kompromisi në mënyrë që të mund të vazhdojë normalizimi i cili do të çojë përfundimisht në njohjen përfundimtare, njohjen e ndërsjellë”, tha ajo.

Poweri tha se nënshkrimi i deklaratës për personat e zhdukur është vetëm një hap për ta ndriçuar fatin e mbi 1 600 personave që mbeten ende të zhdukur, transmeton “Zëri i Amerikës”. “Dhe si anëtare e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të presidentit Joe Biden, jam gjithashtu në rajon për të folur për normalizimin, për marrëveshjen e fundit dhe kuadrin për normalizim që është shumë e rëndësishme të zbatohet”, tha ajo. Poweri ka ardhur në Kosovë pas



një vizite në Serbi, ku ka premtuar mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për Serbinë dhe Kosovën, ndërsa dy vendet armike të kohës së luftës punojnë për t'i stabilizuar marrëdhëniet në një kohë tensionesh të rritura.

Bashkimi Evropian ka shpenzuar 12 vjet duke lehtësuar negociatat ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008, por Serbia nuk e njeh shtetësinë e saj.

Të dyja vendeve u është thënë se duhet t'i normalizojnë marrëdhëniet në mënyrë që të përparojnë në synimet e tyre për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Palët janë pajtuar të mbështetnin një plan të BE-së për këtë çështje, por tensionet mbeten të larta.

Hovenieri mirëpret administratoren Power

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka bërë me dije të premtën se e ka mirëpritur në objektin e ambasadës administratoren e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Samantha Power. Hovenieri në “Twitter” ka shkruar se administratoren Power e ka paraqitur tek ekipi i ambasadës. “E

mrekullueshme për të mirëpritur PowerUSAID tek Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe ta prezantoj atë me ekipin tonë të përkushtuar. Çdo ditë jam mirënjohës për kontributin e tyre në avancimin e prioriteteve tona strategjike, duke përfshirë mbështetjen për një Kosovë gjithëpërfshirëse, demokratike, ekonomikisht të begatë”, ka shkruar Hovenieri.

KMDLNj: Lajçaku kërcënoi Kosovën haptas pas paralajmërimit për hapjen e urës mbi lumin Ibër

PRISHTINË, 12 MAJ - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) e ka akuzuar emisarin e Bashkimit Evropian (BE) për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, për kërcënimin e Kosovës pas paralajmërimit për hapjen e urës mbi lumin Ibër. “Gjatë vizitës së fundit Lajçak kërcënoi haptas në mënyrën më të pamoralshme të mundur se Kosova duhet të përcaktohet midis përshkallëzimit dhe normalizimit me paralajmërimin se do të hapet ura mbi lumin Ibër që do të mundësonte lirinë e lëvizjes për të gjithë qytetarët e Mitrovicës dhe jo vetëm të Mitrovicës, pavarësisht përkatësisë etnike, fetare, moshës, gjinisë apo bindjeve politike. Po në vendin ku Lajçak merr rrogë marramendëse për rolin që po e luan në Kosovë, liria e lëvizjes konsiderohet dhe trajtohet si njëra ndër të drejtat elementare të njeriut. Deri më tani qytetarët e Kosovës kanë qenë të izoluar sa i përket lëvizjes së lirë në Evropë e tani, Miroslav Lajçak me

ndërhyrjet arbitrare në punë të brendshme të një shteti të pavarur dhe sovran, duke kërkuar që ura mbi lumin Ibër të mos hapet për qytetarë në mënyrë të lakuriqësuar po del kundër kësaj vlerë dhe të drejtë të njeriut siç është liria e lëvizjes. Pra, Burgun e Madh për Kosovën e që është mohimi i lirisë së lëvizjes në Evropë po e përkthen në një burg të vogël apo mohimi i lirisë së lëvizjes brenda Kosovës. Pse do të duhej t'i pengonte Lajçakut dhe të tjerëve liria e lëvizjes në atë pjesë të Kosovës nëse është, dhe pa asnjë dyshim edhe është interes i të gjithë qytetarëve”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, Serbia përmes Listës Serbe dhe krimin të organizuar, të përkrahur nga Lajçaku, Borrelli dhe burokratët e BE-së, lirinë e lëvizjes dhe qarkullimin e lirë mbi lumin Ibër po e përdorin si shantazh për përfitime politike duke i kushtëzuar politikanët kosovarë që të bëjnë lëshime politike, si kusht për hapje të urës së Ibrit.



“Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq paralajmëron ditë të vështira për atë pjesë të Kosovës në fund të muajit maj e që qartazi po përputhet me deklaratën e Miroslav Lajçak se situata në veri mund të përshkallëzojë nëse pala kosovare vazhdon përpjekjet për mbrojtje të integritetit territorial

dhe shtrirjes së sovranitetit në atë pjesë të Kosovës. Miroslav Lajçak është hipokrit, është i dëmshëm dhe vetëm sa e pengon procesin e normalizimit të marrëdhënieve sepse e ka humbur besueshmërinë si ndërmjetësues i paanshëm dhe i pandikuar politikisht”, thuhet në reagim.

KMDLNj-ja ka theksuar se institucionet e Kosovës ndodhen para një sfide, pasi janë vendosur në gërrshërë “ose duhet të vazhdojnë të bëjnë lëshime ose do të fajësohen për dështim të procesit të bisedimeve përmes tensionimit të situatës në veri duke ua përmendur zgjedhjet lokale që nuk prodhuan dhe nuk do të prodhojnë asnjë efekt juridik e deri te inaugurimi i kryetarëve të zgjedhur nga një pakicë absolute dhe e parëndësishme në këtë pjesë të Kosovës”.

Sipas KMDLNj-së, me këto zgjedhje dhe përpjekje për inaugurim të kryetarëve që janë zgjedhur në një proces harakiri zgjedhor, Kosova do të akuzohet se po dhunohet vullneti i përfaqësimit politik të shumicës (serbe) nga një pakicë absolute (shqiptare dhe joserbe). “Rreth dhe për Kosovën po luhen lojëra të ndyra dhe të rrezikshme që për qëllim kanë fillimisht federalizimin politikë pastaj edhe atë territorial”, theksohet në reagimin e KMDLNj-së.



NË PRISHTINË MBAHET KONFERENCA "BALKAN DIALOGUES INITIATIVE"

Kurti: Kosova meriton statusin e kandidatit për anëtarësim në BE

Në konferencën "Balkan Dialogues Initiative", kryeministri Albin Kurti ishte folësi kryesor i saj, ku theksoi se Kosova meriton statusin e kandidatit për anëtarësim në BE. Sa i përket dialogut me Serbinë, ai theksoi se janë të përkushtuar, konstruktiv dhe kreativ dhe se beson se Marrëveshja Bazike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përbën një avancim të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, sepse bazohet në parime universale të barazisë së sovranëve

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 12 maj- Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti ishte folës kryesor në konferencën e mbajtur të premten nga Grupi i Ballkanit për Politika me temën "Balkan Dialogues Initiative".

Kryeministri Kurti tha se platformat si këto janë një agora e rëndësishme, ku idetë takohen, përplasen dhe luftojnë me njëra-

tjetrën për të krijuar një sintezë të ekuilibruar.

Fjalimin e tij kryeministri e nisi duke përmendur luftën në Ukrainë, nga siç tha ai agresori rus me ambicie hegemoniste dhe ndërsa njerëzit luftojnë për të mbrojtur lirinë e tyre, koncepte të tilla si liria, uniteti dhe solidariteti duhet të bëhen veprime që drejojnë politikën tonë të jashtme.

Kjo, siç tha ai, është arsyeja pse

Kosova e ka harmonizuar politikën e saj të përbashkët të sigurisë së jashtme me atë të BE-së dhe ka aplikuar të gjitha pakot e sanksioneve ndaj Federatës Ruse. "Nuk ka asnjë mospajtim nëse Kosova duhet të vendosë sanksione dhe të rreshtohet me BE-në, sepse vizioni ynë është i qartë: ne rreshtohemi me kombet paqësore, demokratike në Evropë që mishërojnë lirinë, unitetin dhe solidaritetin dhe jemi në anën e

luftës çlirimtare të populli ukrainas", u shpreh ai.

Në këtë konferencë kryeministri foli edhe për aplikimin për anëtarësim në Këshillin e Evropës në BE.

Pas kalimit me sukses të fazës së parë të anëtarësimit në Këshillin e Evropës, tash së fundmi, raportit pozitiv për vendin të vitit të kaluar dhe vendimit të liberalizimit të vizave pas gjithë asaj vonese, kryeministri Kurti tha se Kosova po pret që të marrë edhe pyetësin për BE, që do të konfirmonte që Kosova meriton statusin kandidat.

Sa i përket dialogut me Serbinë, ai theksoi se janë të përkushtuar, konstruktiv dhe kreativ dhe se beson se Marrëveshja Bazike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

përbën një avancim të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, sepse bazohet në parime universale të barazisë së sovranëve, respektimit të integriteti territorial, pavarësisë, heqjen dorë nga kundërshtimet për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare, shkëmbimin i misioneve diplomatike me ambasadorë, njohja e simboleve shtetërore, vulave doganore, targave dhe e pasaportave.

Në fund, ai tha se reformat e brendshme në sundimin e ligjit, progresi ekonomik dhe social, liberalizimi i vizave dhe suksesi në fazën e parë të anëtarësimit në Këshillin e Evropës, konfirmojnë se po bëjmë hapat e duhur në rrugën e duhur drejt të ardhmes evropiane.

Lajçak: Takimi i kryenegociatorëve të hënën e ardhshme, një mundësi e mirë për hapat e ardhshëm

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 12 maj - Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit, Miroslav Lajçak, është takuar të premten në Beograd me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Ky i fundit pas takimit me Lajçakun ka treguar se ia ka përcjellë shqetësimin e tij për situatën në Kosovë, veçanërisht për veriun. "I thashë ndërmjetësuesit evropian se shqetësimi im buron nga nevoja e [kryeministrit të Kosovës] Albin Kurtit për të provokuar incidente dhe konflikte", ka deklaruar Vuçiq.

Vuçiq gjithashtu në një postim në "Instagram" tha se fokusi i takimit ishte formimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe, "që është parakusht që Serbia t'i vazhdojë bisedimet e mëtejshme me Prishtinën".

Përmes një postimi në rrjetin social "Twitter", Lajçak njoftoi për takimin e tij me presidentin Vuçiq dhe kryenegociatorin Petar Petkoviç, prej ku tha se me ta diskutoi rrugën përpara në zbatimin e marrëveshjes. "Takimi i kryenegociatorëve të hënën e ardhshme është një mundësi e mirë për të rënë dakord për hapat

e ardhshëm konkretë", ka shkruar Lajçak.

Lajçak, i cili ishte në Prishtinë më 11 maj, po qëndron në Serbi për të monitoruar zbatimin e asaj që është vendosur dhe rënë dakord në Bruksel dhe për të përgatitur hapat dhe takimet e ardhshme mes Kosovës dhe Serbisë.

Çfarë tha Lajçak gjatë vizitës në Prishtinë?

Lajçak tha në Prishtinë se do të takohet me kryenegociatorët e dy shteteve në dialog, përkatësisht me Besnik Bislimin dhe Petar Petkoviçin të hënën e 15 majit në Bruksel. "Ne kemi Marrëveshjen, kemi Aneksin, ndaj duhet të kemi një kuptim të qartë të hapit të parë, hapit të dytë dhe hapit të tretë", u shpreh ai, duke shtuar se diskutimi me kryeministrin e Kosovës ishte "shumë intensiv, por shumë i rëndësishëm".

I pyetur gjatë ditës se si e sheh zgjidhjen për formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, kur të dyja palët kanë pikëpamje krejtësisht të kundërta se si duhet të duket, Lajçak tha se "do të ishte naivë të kishim një qëndrim të përbashkët që nga fillimi". "Tani duhet të ulemi dhe të fillojmë të punojmë, të arrijmë një marrëveshje, t'i afrojmë



qëndrimet e njërit dhe tjetrit. Sigurisht, platformë e përbashkët duhet të jenë marrëveshjet e mëparshme dhe modelet evropiane. Aty ku ka vullnet, ka rrugë", ka deklaruar Lajçak.

Pas takimeve me kryeministrin e Kosovës Albin Kurti dhe kryenegociatorin Bislimi, Lajçak tha se kanë biseduar për procesin e normalizimit të marrëdhënieve dhe hapat e ardhshëm pas takimit të liderëve të Kosovës dhe Serbisë më 2 maj në Bruksel.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti në një konferencë për media ritheksoi se Kosova është interesuar të zbatohet në tërësi Marrëveshjen e Ohrit. "Jemi të interesuar që të bashkëpunojmë

për ta shkruar bashkë më tej një vizion për komunitetin serb në Kosovë sa i përket nivelit adekuat të vetëmenaxhimit. Ky është synimi ynë paralelisht me atë që duhet të ketë zbatim të plotë dhe sa më të shpejtë", tha Kurti.

Lajçak vizitoi edhe Mitrovicën e Veriut, prej ku u pyet në lidhje me çështjen e hapjes për qarkullim të urës mbi lumin Ibër, mes Mitrovicës së Jugut dhe asaj të Veriut.

Hapja e kësaj ure u diskutua ditë më parë me iniciativën e disa asamblistëve të Komunes së Mitrovicës së Veriut. "Është në duart e dy palëve, ato duhet të pajtohen. Ne duam që hapja e urës të kontribuojë në një

stabilitet më të madh se sa në destabilizim. Prandaj, insistoj që duhet ta përdorim platformën e dialogut për t'u pajtuar për një rrugë përpara", ka theksuar Lajçak.

Lajçak tha se qëllimi i vizitës së tij në veri është që të marrë "informacionin e dorës së parë nga njerëzit që jetojnë këtu për të parë se si e shohin situatën ata". "Për mua ishte e rëndësishme të vizitoja përsëri veriun e Kosovës dhe të bisedoja me bashkëbisedues të ndryshëm në mënyrë që të krijoja përshtypjen time të drejtpërdrejtë për situatën aktuale. Ajo që dëgjova më shqetësoi. Ne duhet të shmangim çdo mundësi përshkallëzimi dhe të përqendrohemi plotësisht te normalizimi", ka shkruar ai në një postim në "Twitter".

Në fund të vizitës së tij në Kosovë, Lajçak tha se takimet e 11 majit ishin të dobishme për të si i dërguar për dialog dhe se po nisjet për në Beograd me informacione dhe përshtypje të reja.

Kjo është vizita e parë e Lajçakut në Beograd dhe Prishtinë pas takimit të 2 majit Vuçiq-Kurti në Bruksel, ku u miratua Deklarata për Personat e Zhdukur, por nuk u arrit përparim në lidhje me Asociacionin e Komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Weber: Pa kthimin e serbëve në institucione s'mund të ketë zbatim të marrëveshjeve

Prishtinë, 12 maj - Bodo Weber, ekspert për Ballkanin dhe bashkëpunëtor i lartë i Këshillit për Politikën e Demokratizimit në Berlin, mendon se Kosova dhe Serbia do ta kenë të vështirë të zbatohet marrëveshjen e arritur në Bruksel, me situatën aktuale në katër komunat veriore me shumicë serbe.

Weber thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Bashkimi Evropian bëri gabim kur arriti një marrëveshje mes dy shteteve në fillim të këtij viti pasi shumica e serbëve të Kosovës në veri u dorëhoqën nga institucionet nga nëntori i vitit të kaluar dhe ende nuk ka plan për rikthimin e tyre. "Pa u zgjidhur kjo çështje, mendoj se nuk do të shohim zbatim të marrëveshjes bazë dhe kjo është ajo që po shohim, jo vetëm nga (Marrëveshja e) Brukselit, por edhe nga marrëveshja për Aneksin e Zbatimit në Ohër", tha Weber.

Kosova dhe Serbia, aktualisht, janë duke diskutuar për çështjen e themelimit të një Asociacioni të komunave me shumicë serbe. Më 2 maj, Qeveria e Kosovës refuzoi një draft-statut që iu prezantua për këtë asociacion, dhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, propozoi një "draft-vizion" të tij për këtë qëllim gjatë një takimi që zhvilloi me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel. Vizioni i tij, siç thotë Kurti,



bazohet në një model kroat për pakicat kombëtare dhe siç tha më 11 maj, ai është i interesuar që të bashkëpunojë "për ta shkruar e definuar edhe më tutje këtë vizion për komunitetin serb në Kosovë".

Duke e komentuar këtë propozim të Kurtit, Weber thotë se problemi nuk qëndron te një model apo tjetër i Asociacionit, por tek i gjithë koncepti i një bashkimi një-etnik me rrezik të

keqpërdorimit nga Serbia. "Kjo është sfida që nuk mund të zgjidhet nga asnjë model. Pra, duhet të gjendet një rrugë e mesme në mes të implementimit të kësaj ideje (të Asociacionit), por duke e bërë në diçka që mundet në të vërtetë të forcojë qeverisjen lokale, por edhe diçka që nuk ndërtohet në një formë që në të ardhmen mund të përdoret si një vegël për Serbinë që të përzihet në çështje

të brendshme të Kosovës", thotë ai.

Sipas Weberit, arsyeja pse Asociacioni si i tillë mund të shkaktojë problem është për faktin se serbët e Kosovës (shumica) udhëhiqen nga një parti - Lista Serbe - e cila ka lidhje të njohura me Beogradin. Ai thotë se demokratizimi i politikës së këtij komuniteti duhet të bëhet me intervenimin e Perëndimit.

I dërguari i posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun me Serbinë, Miroslav Lajçak, vizitoi Kosovën dhe gjatë vizitës bisedoi edhe me qytetarë e përfaqësues politikë të serbëve në veri.

Lajçak u takua edhe me përfaqësuesit e Listës Serbe në Mitrovicën e Veriut.

Ai tha se qëllimi i vizitës së tij në veri ishte që të marrë "informacionin e dorës së parë nga njerëzit që jetojnë këtu për të parë se si e shohin situatën ata". "Ajo që dëgjova më shqetësoi. Ne duhet të shmangim çdo mundësi përshkallëzimi dhe të përqendrohemi plotësisht te normalizimi", shkroi ai në një postim në "Twitter".

Pas takimit, Lista Serbe njoftoi se me Lajçakun biseduan për situatën politike dhe të sigurisë dhe se vlerësojnë që Prishtina "çështjet e hapura i zgjidh me lëvizje të njëanshme dhe dhunë

institucionale".

Lista Serbe deklaroi se nuk i njeht rezultatet e zgjedhjeve që janë mbajtur në komunat në veri.

Më 23 prill të këtij viti, në katër komunat me shumicë serbe në Kosovë u mbajtën zgjedhjet lokale për kryetarë komunash. Këto zgjedhje u shpallën pasi shumica e serbëve të asaj zone dhanë dorëheqje nga institucionet e Kosovës. Serbët, në përgjithësi, i bojkotuan zgjedhjet dhe në katër komuna u zgjedhën përfaqësues shqiptarë përmes votave nga një dalje shumë e ulët e votuesve.

Sipas të dhënave të KQZ-së, në zgjedhje dolën 1.567 votues apo 3.47 për qind e numrit të përgjithshëm të qytetarëve atje me të drejtë vote.

Më 2 maj, në Bruksel është mbajtur rundi i fundit i dialogut në nivel të lartë, mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Kosova dhe Serbia janë duke zhvilluar negociatën për normalizimin e marrëdhënieve qysh nga viti 2011.

Marrëveshja për Asociacionin e komunave me shumicë serbe është arritur në vitin 2013, por nuk është zbatuar kurrë.

Serbia ka këmbëngulur në kompetenca të gjera për këtë asociacion, ndërsa Kosova ka thënë se të tillat do ta rrezikonin funksionalitetin e shtetit.

Komuna e Mitrovicës shpreh gatishmëri për mbështetjen e personave me nevoja të veçanta

MITROVICË, 12 MAJ - Nënkrjetari i komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri, së bashku me drejtorin për Siguri dhe Emergjencë, Bahtir Maxhuni, pritën në takim përfaqësuesit e prindërve të fëmijëve të

Organizatës Joqeveritare "Handikos".

Të pranishmit nga përfaqësuesit komunalë kërkuan mbështetje institucionale si dhe ofrimin e kushteve më të mira për

fëmijët me nevoja të veçanta në mënyrë që të ndihen të barabartë në shoqëri.

Me këtë rast, nënkryetari Tahiri ofroi gatishmërinë për mbështetjen e kësaj kategorie të shoqërisë sonë, duke

theksuar përkrahjen e dhënë nga komuna për organizata të cilat mbrojnë të drejtat e personave me nevoja të veçanta, qoftë me projekte apo përmes ofrimit të kushteve dhe integritetit të tyre në shoqëri.



BE-ja: Qeveria e Kosovës ta respektojë Ligjin për Shpronësim në veri

PRISHTINË, 12 MAJ - Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë u bëri thirrje autoriteteve të Kosovës "t'i respektojnë me përpikëri procedurat ligjore në lidhje me shpronësimin e pronës së paluajtshme" dhe të bëjnë gjithçka që kanë në dorë për të garantuar respektimin e të drejtave pronësore të pronarëve të tokave.

Sipas BE-së, Qeveria e Kosovës duhet të ndjekë një sërë procedurash përpara përfundimit të procesit, sepse shpronësimi është një proces i ndjeshëm nga natyra. "Procedurat ligjore parashikojnë hapa të tillë si njoftimi i avancuar dhe informacioni gjithëpërfshirës i pronarëve të pronave, e drejta e tyre për të paraqitur komente mbi shpronësimin e kërkuar, mundësia e një mjeti të përshtatshëm juridik

dhe kompensimi adekuat i tyre përpara se procesi të përfundojë", nënvizon deklarata e BE-së.

Më 10 maj Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për shpronësimin e tokave në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, Leposaviq dhe Zubin Potok.

Siç është paralajmëruar nga autoritetet e Kosovës, shpronësimi kryhet me qëllim të "realizimit të projekteve infrastrukturore me interes publik".

Aksionet përgatitore për shpronësimin e tokës në Leposaviq kanë filluar në fillim të vitit, por popullata vendase serbe e kundërshton ashpër atë, duke pretenduar se është një "proces i paligjshëm".

Ata, po ashtu, theksojnë se

problemi më i madh për serbët në veri është se qëllimi i shpronësimit është ndërtimi i një baze për policinë kufitare të Kosovës.

Policia e Kosovës më herët ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se në fshatin Dren, në komunën e Leposaviqit, ka filluar puna për ndërtimin e stacionit policor kufitar, "me qëllim të sigurimit të qytetarëve, menaxhimit të kufirit dhe parandalimit të kontrabandës në atë rajon".

BE-ja thotë se e sheh me shqetësim ndërtimin e bazave dhe bëri u thirrje autoriteteve për adresim adekuat të procesit. Sipas BE-së, "themelimi i katër bazave të Policisë së Kosovës në tokë private dhe shoqërore - në disa raste para fillimit të procedurave të



shpronësimit - ngre shqetësime për të drejtat pronësore në veri të Kosovës dhe duhet të adresohet në mënyrë adekuate nga autoritetet". Në mes të shkurtit, përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës mbajtën një seancë të hapur dëgjimore në Leposaviq dhe Zubin Potok pasi

serbët vendas kundërshtuan shpronësimin. Po ashtu, pronarët e parcelave që janë objekt i shpronësimit kanë paraqitur padi në gjykatat kompetente në Prishtinë për të parandaluar atë që ata e konsiderojnë proces të kundërligjshëm.

Mehaj: Ushtarët e Kosovës, të gatshëm për çdo sfidë



PRISHTINË, 12 MAJ - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se në kuadër të përgatitjeve për ushtrimin fushor "Defender Europe 23", Regjimenti i Parë i Forcave

Tokësore është duke kryer përgatitjet finale për ushtrim. Mehaj në "Facebook" ka shkruar se Kompania B e Regjimentit të Parë të Këmbëorisë përgjatë dy javëve ka realizuar patrullimet

luftarake në kushte të natës. "Të gatshëm për çdo sfidë. Në kuadër të përgatitjeve për ushtrimin fushor 'Defender Europe 23', Regjimenti i Parë i Forcave Tokësore është duke

kryer përgatitjet finale për ushtrim. Kompania B e Regjimentit të Parë të Këmbëorisë përgjatë dy javëve ka realizuar patrullimet luftarake në kushte të natës.

Qëllimi i këtij ushtrimi ishte aftësimi i pjesëtarëve për manovrim dhe drille të betejës gjatë natës me anë të pajisjeve të natës (NVG)", ka shkruar Mehaj.

Komuna e Prishtinës dhe "Ibër Lepenci", memorandum bashkëpunimi për një projekt rrugor

PRISHTINË, 12 MAJ - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, së bashku me kryeshefin e "Ibër Lepencit", kanë nënshkruar memorandum të

mirëkuptimit për punimet e një projekti rrugor të kryeqytetit me infrastrukturën e kësaj ndërmarrjeje. Rama ka bërë me dije se

qëllimi i këtij memorandum bashkëpunimi është realizimi i projektit infrastrukturor "Ndërtimi i rrugës 'Dëshmorët e Ponoshecit'" në Prishtinë,

duke ruajtur koordinatat, infrastrukturën, funksionalitetin dhe pozitën e shtrirjes së gypit nëntokësor, aset i NH "Ibër Lepenc" Sh.A..



Dhoma e Tregtisë kërkon pagesën e punëtorëve nga 'Superpuna'

PRISHTINË, 12 MAJ - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të bëhet ekzekutimi i menjëhershëm i pagesave për të gjitha bizneset të cilat tashmë kanë rekrutuar staf përmes platformës 'Superpuna'. "Pas ankesave të vazhdueshme të pranuar nga bizneset, Dhoma e Tregtisë shpreh shqetësimin e saj lidhur me vonesat e pagesave për punëtorët e rekrutuar përmes kësaj platforme, pagesa këto të cilat fillimisht duhet të kryhen nga bizneset në mënyrë vetjake për të gjithë të punësuarit e tek më pas të bëhet rimbursimi nga

Qeveria e Kosovës", është thënë në reagimin e Dhomës së Tregtisë. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë ka theksuar se aktualisht subvencionimi nga qeveria bëhet me një muaj diferencë, ngaqë deklarimi i punëtorëve në ATK bëhet deri më 15 të muajit vijues të angazhimit. "Pra, për punëtorët e angazhuar në muajin mars, deklarimi në ATK bëhet deri më 15 prill. Ky proces po zvarritet, konkretisht tek në muajin maj është bërë subvencionimi i kompanive për muajt shkurt dhe mars. Duke pasur parasysh kostot rreth përgatitjes së kërkesës,



aprovimit, pagesës e tek me vonë kompensimit, ne mendojmë se ky proces do të duhej të thjeshtësohej duke bërë që autoritetet t'i paguajnë

praktikantët direktë në vend se të përlogarit pensioni e taksa bashkë me shumën e subvencionuar e cila për nga natyra nuk do të duhet të ishte e

tatueshme", është thënë në këtë reagim.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë ka shtuar se bizneset nuk duhet të detyrohen të hyjnë në borxhe në banka për të kryer paga dhe më vonë ta presin kompensimin nga qeveria me data të paqarta. "Për më tepër, të gjitha kompanitë për të punësuar staf përmes platformës 'Superpuna' duhet të mos kenë obligime në Administratën Tatimore të Kosovës, sfidë që e kanë shumica e bizneseve në këtë situatë të jashtëzakonshme për të bërë biznes", është thënë në reagimin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë.

Shkalla e parë e sistemit gjyqësor të Kosovës zgjidh vetëm 31 për qind të lëndëve të korrupsionit në 2022-n

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 MAJ - Lëvizja FOL, me mbështetjen e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit, ka publikuar të premten raportin "Performanca e Sistemit Prokurorial dhe Gjyqësor në Zgjidhjen e Lëndëve të Korrupsionit gjatë vitit 2022", i cili adreson çështjen e performancës së këtyre dy sektorëve në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 si dhe shtjellon nivelin e ngarkesës

së punës së këtyre institucioneve në zgjidhjen e këtyre lëndëve. Sipas këtij raporti, shkalla e parë e sistemit gjyqësor të Kosovës gjatë vitit 2022 ka pasur në punë gjithsej 268 lëndë të korrupsionit, numër ky që në raport me vitin 2021 (ku ishin 383 lëndë në punë) ishte zvogëluar për 20 për qind. Prej këtyre lëndëve të korrupsionit në punë, 59 për qind kanë qenë të bartura nga vitet paraprake, ndërsa 41 për qind kanë qenë lëndë të reja të krijuara gjatë vitit 2022. "Nga 268 lëndët e korrupsionit në punë, shkalla e parë e sistemit gjyqësor ka arritur

të zgjidhë 81 lëndë, apo vetëm 31 për qind të të gjitha lëndëve që i ka pasur në punë gjatë vitit 2022. Ndërsa pjesa tjetër prej 184 lëndëve, apo 69 për qind e tyre, kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur për vitin 2023", thuhet në këtë raport. Këto shifra tregojnë për ulje të nivelit të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit nga ana e shkallës së parë të sistemit gjyqësor në krahasim me vitin 2021, ku këto institucione kishin zgjidhur 38 për qind të lëndëve të korrupsionit që i kanë pasur në punë. Nga 81 lëndët e zgjidhura gjatë

këtij viti, janë nxjerrë 41 aktgjykime fajësuese, 23 aktgjykime liruese, 4 aktgjykime refuzuese, si dhe 14 lëndë janë zgjidhur në mënyra të tjera. "Gjatë kësaj periudhe, 42 persona janë dënuar me burgim, 22 persona janë dënuar me kusht, 31 persona janë dënuar me gjobë, ndërsa për 5 persona është shqiptuar dënimi plotësues: ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike", është theksuar në raport. Albana Hasani, hulumtuuese e lartë në Lëvizjen FOL, tha se raporti është bazuar në të dhënat

statistikore zyrtare të pranuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës për vitin 2022, ndërsa për matjen e performancës së këtyre institucioneve mbi bazën e këtyre statistikave zyrtare, Lëvizja FOL ka përdorur metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ). "Duhet të bëhet e qartë se raporti nuk përfshin cilësinë e lëndëve, apo cilësinë e punës së prokurorive dhe gjykatave, por ajo shtrihet vetëm në matjen kuantitative të tyre", ka thënë Hasani.

Dy raste të pengimit të punës së gazetarëve nga mbrojtja e afërt e kryeministrit dhe ministres Rizvanolli

PRISHTINË, 12 MAJ - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës është i shqetësuar pas denoncimit të gazetarit, Kosovë Gjoci, të "Euronews Albania", për pengimin në punë nga mbrojtja e afërt e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti.

Gjoci ka njoftuar se dy individë nga mbrojtja e Kurtit e kanë penguar në punë -

njëri e ka shtyrë duke ia dëmtuar pajisjet, kurse tjetri e ka kërcënuar me fjalët "këqyrem mirë në sy e mbajmë në mend". Sipas gazetarit Gjoci, kryeministri Kurti e ka parë skenën dhe nuk ka reaguuar, që e bën rastin edhe më të rëndë.

Para disa ditësh edhe gazetarja e "Periskopi"-t, Besarta Hoti, u pengua në

përpjekjet për të bërë pyetje për Ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli. AGK-ja i konsideron këto veprime të papranueshme dhe i bën thirrje qeverisë dhe dikastereve të saj të mundësojnë kushte elementare të punës për gazetarët kur raportojnë dhe kërkojnë përgjigje nga anëtarë të ekzekutivit.



Kosova, përfituese e Programit të BE-së 'Tregu i Përbashkët' me vlerë 4.2 miliardë euro

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

BRUKSEL, 12 MAJ - Në ambientet e Komisionit Evropian në Bruksel, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Rozeta Hajdari dhe drejtoresha e përgjithshme për Tregun e Brendshëm të Bashkimit Evropian, Industrinë, Ndërmarrësinë dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (DG GROW), Kerstin Jorna, kanë nënshkruar marrëveshjen për përfshirjen e Republikës së Kosovës në Programin e Bashkimit Evropian "Tregu i Përbashkët" për periudhën kohore 2021-2027.

Pjesëmarrja në programin e BE-së "Tregu i Përbashkët" për Kosovën, është një hap shumë i rëndësishëm drejt procesit të integritimit të Kosovës në BE. "Programi në fjalë është njëri ndër programet më të mëdha mbështetëse që posedon Bashkimi Evropian dhe si i tillë

synon fuqizimin e mbikëqyrjes së tregut të brendshëm, përmirësimin e konkurrueshmërisë së industrisë, në veçanti të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (SME), mbrojtjen e konsumatorit përfshirë sigurinë e ushqimit, përmirësimin e statistikave dhe përmirësimin e sektorit financiar", ka thënë ministrja Hajdari.

Ajo ka treguar se përmes këtij programi të BE-së "Tregu i Përbashkët", bizneset dhe organizatat e Kosovës mund të ndërveprojnë me bizneset dhe organizatat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe shteteve në proces të anëtarësimit në BE.

Programi "Tregu i Përbashkët" do të mbështesë sektorët e sipërpërmendur me një buxhet prej 4.2 miliardë euro për periudhën kohore 2021-2027, e që nga tani bizneset dhe organizatat vendore mund të përfitojnë nga ky



program.

Në lidhje me mënyrën e aplikimit dhe përfitimit nga ky program bizneset dhe organizatat vendore do të njoftohen me kohë nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në

mënyrë që ta shfrytëzojnë maksimalisht këtë mundësi shumë domethënëse për zhvillimin e përgjithshëm dhe transformimin ekonomik të vendit tonë.

Ministrja Hajdari ka falënderuar ekipet negociatore,

nga Qeveria e Kosovës të udhëhequr nga Irfan Lipovica dhe nga Komisioni Evropian të udhëhequr nga Francesca Porcelli. "Kosova është njëra ndër vendet e para që bëhet pjesë e këtij programi", ka theksuar Hajdari.

Rritja e normave bankare, goditje për sektorin privat

PRISHTINË, 12 MAJ - Kërkesa e Fondit Monetar Ndërkombëtar për të rritur normat e interesit ka ngjallur pajtime dhe mospajtime në vend. Disa ekonomistë mendojnë se rritja e interesit të kredive do të stoponte inflacionin e disa të tjerë konsiderojnë se kjo do ta ngufasë sektorin privat në Kosovë. Aktualisht normat e interesit të kredive në vend janë 6.5 për qind.

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka kërkuar nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) që të vazhdojë t'i rrisë normat e interesit deri në mes të vitit 2024, në përpjekje për të kontrolluar inflacionin në vendet e Bashkimit Evropian.

Por disa ekonomistë janë të pajtimit që të rriten këto norma në mënyrë që të ulët inflacionin e disa të tjerë e shohin si shqetësuese rritjen e normave të kredive.

Për ekonomisti Arian Sahiti, kjo rritje do të ishte e domosdoshme. "Kjo normalisht



që ka impakt edhe te ne në Kosovë, sepse ne e ndjekim Euriborin. Kështu impakti ka me qenë tek ata të cilët do të marrin kredi të reja dhe ata që janë ekzistues. Në anën tjetër të masat e gjera të popullit impakti ka me qenë pozitiv, sepse stopohet sasia e madhe e parave

në treg dhe kur nuk ka sasi të madhe të parave në treg, atëherë çmimet kanë tendencë të bien. Rrjedhimisht nëse produktet nuk shiten gjithsesi që do të bien çmimet", tha ai për "Radio Kosovën".

Por për ekspertin e Ekonomisë, Safet Gërxhaliu, thirrja për rritje

të normave të kredive është shumë shqetësuese.

Ai tha se për sektorin privat kjo do të jetë sfidë e madhe. "Në rend të parë duhet të kuptohet se në Kosovë përballë krizës nuk kemi seriozitet dhe po neglizhohen shumë procese. Në rend të dytë kërkesa e Fondit

Monetar Ndërkombëtar drejtuar Bankën Qendrore Evropiane, ka qenë shumë shqetësuese, ku kërkohet me ngulm që të rriten kamatat në kredi që të luftohet inflacioni, ndërsa Kosova në këtë drejtim është para sfidave të shumta, sepse në një anë e kemi inflacionin që është shumë shqetësuese në anën tjetër e kemi Evropën e cila siç duket nuk do të mund t'i shpëtojë recesionit. Për sektorin privat do të jetë sfiduese e ardhmja, sepse sot në Kosovë kemi kamata bankare afër 7 për qind, nëse vazhdohet në këtë drejtim, këto kamata do të kenë trend rritës dhe do të ketë një ngufatje të sektorit privat", tha Gërxhaliu për Radio Kosovën.

Norma mesatare e interesit në kredi në bankat komerciale, sipas Bankës Qendrore të Kosovës është 6.5 për qind.

Euribori ndërkraç është rritur brenda pak muajve nga 0.45 në 3.8 për qind.

Falsifikim i parashë, policia njofton për pesë raste të reja

PRISHTINË, 12 MAJ - Policia e Kosovës ka raportuar për pesë raste të falsifikimit të parashë, vetëm brenda disa ditësh. Të gjitha paratë janë konfiskuar dhe Policia ka iniciuar dy raste në Prizren, një në Pejë, një rast në Gjakovë dhe një në Ferizaj.

Sipas raportit 24 orësh të Policisë së Kosovës, të enjten në Prizren një femër ka raportuar se nga një person i dyshuar janë pranuar një shumë parash, në mesin e të

cilave ka rezultuar një kartëmonedhë në vlerë prej 100 euro që dyshohet të jetë e falsifikuar. Ndërsa rasti tjetër në Prizren tregon për para të falsifikuara në vlerë prej 200 euro. "Ankuesi mashkull kosovar ka njoftuar se nga një person i panjohur ka pranuar një kartëmonedhë në vlerë 200 euro që dyshohet se është e falsifikuar. Kartëmonedha e dyshuar është sekuestruar", thuhet në raportin e Policisë. Sa i përket rastit në Pejë, i njëjti

ka ndodhur më 2 maj por është raportuar pas një jave. Kartëmonedhat e dyshuara janë sekuestruar dhe rasti është duke u hetuar.

Policia ka njoftuar edhe për 100 euro të tjera që dyshohet të jenë të falsifikuara, 50 prej tyre në Gjakovë dhe 50 në Ferizaj. Pas konfiskimit të parave, të dy rastet janë duke u hetuar. "Gjakovë 11.05.2023-09:50. Ankuesja femër kosovare ka njoftuar se nga një person është pranuar një



shumë parash në mesin e të cilave një kartëmonedhë në vlerë 50 euro dyshohet të jetë e falsifikuar. Kartëmonedha e

dyshuar është sekuestruar. Rasti është duke u hetuar", thuhet në raportin e Policisë së Kosovës.

Ne kemi dy vizione të së ardhmes, dhe që të dyja janë të gabuara

Nga Jerome ROOS

“Përgjatë historisë ka epoka të qeta, të cilat duket se përmbajnë atë që do të zgjasë përgjithmonë. Por ka edhe epoka ndryshimi, të cilat sjellin trazira që në raste ekstreme duket se prekin rrënjët e vetë njerëzimit”- shkroi dikur filozofi Karl Jaspers. E jona është padyshim një epokë trazirash.

Ndërsa lufta në Evropë dhe në botë po i shtohet koston së pandemisë më vdekjeprurëse në kujtesën e gjallë, në planet dominon një ndjenjë e thellë pesimizmi. Pas viteve të trazirave ekonomike, sociale dhe të paqëndrueshmërisë politike, ekziston një ndjenjë e përhapur se bota gjendet në prag të shfarosjes. Ajo duket si një anije pa timon në një stuhi të tmerrshme. Dhe arsyet për këtë janë më se të dukshme. Njerëzimi përballet sot me një ndërthurje sfidash që janë ndryshe nga të tjerat në historinë e tij. Ndryshimi i klimës po ndryshon me shpejtësi kushtet e jetës në planetin tonë.

Tensionet rreth Ukrainës dhe Tajvanit, kanë ringjallur spektrin e një konflikti midis superfuqive bërthamore. Ndërkohë zhvillimet marramendëse në Inteligjencën Artificiale po ngrënë shqetësime serioze për rrezikun e një katastrofe globale të shkaktuar nga AI.

Kjo situatë shqetësuese kërkon perspektiva të reja për të kuptuar një botë që po ndryshon me shpejtësi dhe për të përcaktuar se ku mund të shkojmë. Në vend të kësaj, po na paraqiten dy vizione të njohura, por shumë të ndryshme mbi të ardhmen: një narrativë e fundit të botës, që e sheh kudo Apokalipsin, dhe një narrativë e progresit, i cili pohon se kjo që po shohim është më e mira nga të gjitha botët e mundshme.

Të dyja pikëpamjet janë sa të fuqishme në pretendimet e tyre, po aq edhe mashtruese në analizën e tyre. E vërteta është se askush nga ne nuk mund ta dijë se ku po shkojnë gjërat. Kriza e kohës sonë po e mban peng të ardhmen. Parashikuesit ndoshta do të luten që gjërat të ndryshojnë.

Në këndvështrimin e tyre, njerëzimi ndodhet aktualisht në prag të ndryshimeve kataklizmike të cilat do të kulmojnë në mënyrë të pashmangshme në shembjen e qytetërimit modern dhe në fundin e botës siç e njohim ne. Është një këndvështrim që reflektohet tek numri në rritje i atyre që përgatiten për fundin e botës, bunkerëve të miliardërëve dhe serialeve televizive post-apokaliptike.

Ndërsa mund të jetë joshëse që dukuri të tilla kulturore të hidhen poshtë si jo serioze në thelbin e tyre, ato përfaqësojnë një aspekt të rëndësishëm të gjendjes aktuale shpirtërore, duke zbuluar ankthet e rrënjësura thellë rreth brishtësisë



së rendit ekzistues. Por sot këto frikëranuk mund të kufizohen më tek disa njerëz fanatikë të konspiracioneve.

Sulmi i pamëshirshëm i krizave tronditëse, i shpalosur në sfondin e përmbajtjeve të shpejta dhe zjarreve të mëdha nëpër pyje, e ka zhvendosur vazhdimisht në qendër të vëmendjes ndjenjën e fundit të botës. Kur edhe kreu i Kombeve të Bashkuara paralajmëron se rritja e nivelit të detit mund të shkaktojë “një eksod masiv në shkallë biblike”, atëherë është e vështirë të mbetesh i sigurt për gjendjen e botës.

Një sondazh zbuloi se më shumë se gjysma e të rinjve besojnë tani se “njerëzimi është i dënuar të shkatërrohet” dhe se “e ardhmja është e frikshme”. Po ashtu, vitet e fundit kanë parë gjithashtu ringjalljen e një narrative shumë të ndryshme. E ilustruar nga një mori librash bestseller dhe fjalimesh virale në platformën TED, kjo pikëpamje tenton të minimizojë sfidat me të cilat përballemi dhe këmbëngul tek marshimi i paepur i përparimit njerëzor.

Në rast se mendimtarët që profetizojnë fundin e botës shqetësohen pafundësisht se gjërat do të përkeqësohen shumë, profetët e përparimit pohojnë se gjërat vetëm sa janë duke u përmirësuar, dhe ka të ngjarë të vazhdojnë ta bëjnë këtë në të ardhmen.

Skenari panglosian i pikturuar nga këta optimistë, mbështet mbrojtësit e statuskuosë. Por nëse gjërat po përmirësohen vërtet, atëherë nuk ka nevojë për ndryshime transformuese për t’u përballur me problemet më urgjente të kohës sonë. Për sa kohë

që ne i përmbahemi skenarit dhe ruajmë besimin tonë në cilësitë shpenguese të zgjuarsisë njerëzore dhe inovacionit teknologjik, të gjitha problemet tona përfundimisht do të zgjidhen vetë. Këto dy vizione, duken të jenë diametralisht të kundërta. Në fakt, ato janë dy anët e së njëjtës medalje. Të dyja këndvështrimet e vënë theksin tek një grup tendencash mbi një tjetër. Optimistët i referohen shpesh të dhënave mashtruese mbi reduktimin e varfërisë si një dëshmi se bota po bëhet një vend më i mirë.

Ndërkaq, pesimistët priren të fokusohen tek skenarët më të këqij të degradimit të klimës apo kolapsit financiar, dhe t’i paraqesin si fakte të pashmangshme këto mundësi reale. Është e lehtë të kuptosh tërheqjen e publikut nga narrativa të tilla të njëanshme.

Por për ta kuptuar vërtet natyrën komplekse të epokës aktuale, ne duhet para së gjithash të përqafojmë aspektin e saj më të tmerrshëm: pasiguria e pafundme e saj. Është pikërisht kjo pasiguri – të mos diturit se ku jemi dhe çfarë na pret përpara – ajo që shkakton një ankth ekzistencial.

Antropologët kanë një emërtesë për këtë lloj eksperience shqetësuese: liminalitet. Tingëllon shumë teknike, por përshkruan një aspekt thelbësor të gjendjes njerëzore. Me origjinë nga fjala latine që do të thotë prag, liminaliteti i referohej fillimisht ndjenjës së çorientimit që lind gjatë një riti kalimi.

Për shembull, në një ritual tradicional të kalimit në moshë madhore, ai shënon pikën në të cilën adoleshenti nuk

konsiderohet më fëmijë, por nuk njihet ende si i rritur. Pra as këtu dhe e as atje. Pyesni çdo adoleshent: Një gjendje e tillë pezull, mund të jetë një kohë shumë trazuar për të jetuar.

I gjithë njerëzimi është sot në mesin e një tranzicioni të dhimbshëm, një lloj ‘interregnum’ siç e quante dikur teoricieni politik italian Antonio Gramsci, midis një bote të vjetër që po vdes dhe një reje që po përpqet të lindë. Ndryshime të tilla epokale janë pashmangshmërisht të mbushura me rreze.

Por me gjithë potencialin e tyre shkatërrues, ato janë gjithashtu plot mundësi. Siç vuri në dukje dikur historiani i shekullit XIX-të, Jacob Burckhardt, trazirat e mëdha në historinë botërore mund të shihen po aq “si shenja të vërteta vitaliteti” që “e pastrojnë terrenin” nga idetë e diskredituara dhe institucionet e degraduara.

“Kriza duhet të konsiderohet si një syth i ri i rritjes”- shtoi ai. Pasi e përqafojmë këtë natyrë të kohës sonë me fytyrë nga Janusi, njëherësh e frikshme por gjenuese, na shfaqet një vizion shumë i ndryshëm për të ardhmen. Ne nuk e konceptojmë më historinë si një vijë të drejtë që priret ose drejt përmirësimit gradual ose poshtë drejt një kolapsi të pashmangshëm. Përkundrazi, shohim faza të qetësisë relative, të shoqëruara herë pas here nga periudha të trazirave të mëdha. Këto kriza mund të jenë shkatërruese, por ato janë njëherazi edhe shtytëset e historisë. Progresi dhe katastrofa, edhe pse të kundërta, janë vërtet të bashkuara në skaje. Së bashku, ato përfshihen në një vallëzim të



pafundmë shkatërrimi krijues, duke krijuar përgjithmonë terrere të reja dhe duke u futur në spirale drejt së panjohurës.

Epoka jonë e trazirave mund të sjellë ndonjë katastrofë globale apo edhe një kolaps të qytetërimit modern. Por po ashtu mund të krijojë mundësi për ndryshime transformuese. Ne tashmë mund t’i shohim këto dinamika kontradiktore kudo rreth nesh. Një pandemi që vrau miliona njerëz dhe gati shkaktoi një kolaps ekonomik global, i ka fuqizuar punëtorët dhe ka rritur shpenzimet e qeverive për zhvillimin e vaksinave, të cilat së shpejti mund të na japin një kurë për kancerin.

Ngjashëm një luftë e madhe tokësore evropiane, që ka sjellë zhvendosjen e miliona njerëzve, dhe ka shkaktuar një krizë energjetike globale, po përshpejton pa dashje kalimin drejt energjisë së rinovueshme, duke na ndihmuar në luftën kundër ndryshimeve klimatike.

Zgjidhjet që ndjekim sot – mbi paqen globale, tranzicionin e energjisë së pastër dhe rregullimin e veprimtarisë së AI – do të formojnë bazën për një rend të ri botëror. Sigurisht, është e pamundur të parashikohet se ku do të çojnë këto zhvillime. Gjithçka që dimë është se riti ynë qytetëruar i kalimit na ka hapur një derë për të ardhmen. Varet nga ne për të ecur drejt.

Shënim: Jerome Roos, ekonomist politik, sociolog dhe historian në Shkollën Ekonomike të Londrës. Libri i tij i ardhshëm është një histori mbi krizat globale. / “New York Times” – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Duka, thirrje atyre që për inate personale pengojnë FFK-në: Hiqni dorë nga kjo sjellje

PRISHTINË, 12 MAJ - Presidenti i FShF-së, njëherësh anëtar i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s, Armand Duka, gjatë fjalimit të tij në Asamblenë e FShF-së, ka folur edhe për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm të federatave të tri vendeve, Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë e Veriut, derisa ka folur edhe për pengesat që po i bëhen FFK-së nga individë të ndryshëm. “E them me shumë kënaqësi se tri federatat tona kanë krijuar një klimë fantastike për të mirën e futbollit përmes shkëmbimit të eksperiencave, ndihmës që i japim njëri-tjetrit, organizimit të aktiviteteve të shumta etj. Së fundmi në Kosovë kemi pasur një situatë të pakëndshme, e cila vetëm futbollit nuk i shërben ose e dëmton atë. Uroj që kjo situatë të jetë tejkaluar pas licencimit të FFK-së dhe klubeve nga Ministria e Sportit për t’i hapur

rrugën zhvillimit të futbollit”, ka thënë Duka. Ai u ka bërë thirrje të gjithë atyre që pengojnë mbarëvajtjen e punës së FFK-së që të heqin dorë nga kjo sjellje.

“U bëj thirrje nga kjo asamble edhe atyre individëve që për arsye apo inate personale pengojnë mbarëvajtjen e punës në FFK, që të heqin dorë nga kjo sjellje dhe t’i bashkojnë forcat e energjitë me presidentin Ademi, Komitetin Ekzekutiv dhe administratën e FFK-së për të mirën e lojës sonë. Për të mirën e futbollit në Kosovë”, ka nënvizuar Duka. Ai gjatë fjalimit të tij ka folur edhe për të arriturat e futbollit shqiptar dhe për projektet e së ardhmes, me qëllim që futbollit në Shqipëri të ketë infrastrukturë sa më moderne dhe të jetë i kapshëm për të gjitha shtresat.

Ndërsa kreu i FFK-së, Agim



Ademi, mori pjesë në Asamblenë e Zakonshme Vjetore të Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), e cila u mbajt të premtën në Tiranë. Me këtë rast, Ademi ka

përhëndetur punimet e kësaj asambleje dhe përfaqësuesit e FIFA-s, Lorenzo Cavallari dhe të UEFA-s, Denis Bastari. Ademi e ka përgëzuar presidentin Armand Duka për

rizgjedhjen e tij në Komitetin Ekzekutiv të UEFA-s. Kreu i FFK-së ka theksuar se rizgjedhja e Armand Dukës në organin drejtues të futbollit evropian dhe votat maksimale të marra janë dëshmi e punës së shkëlqyeshme të tij dhe një privilegj jo vetëm për futbollin në Shqipëri, por edhe për futbollin mbarëkombëtar dhe atë rajonal. Ademi e ka inkurajuar FShF-në drejt krijimit të infrastrukturës sportive moderne në të gjithë vendin, e cila do të ndikojë edhe në rritjen e cilësisë së futbollit. Në fjalën e tij, presidenti Ademi ka shprehur mbështetjen e tij për Kombëtaren e Shqipërisë dhe i ka uruar sukses në kualifikimet për “Euro 2024”. Ndërkohë, presidenti Armand Duka në fund të fjalimit i ka dhuruar presidentit një pllakate mirënjohjeje dhe një top me emblemën e FShF-së.

Gjilan - Drita, derbi në elitën e futbollit



GJILAN, 12 MAJ - Ndeshjet e radhës në Superligën e Kosovës në futboll zhvillohen në fundjavë. Java e 34-t do të sjellë sfida interesante që mund të jenë përcaktuese për fatin e këtij kampionati, i cili tashmë ka hyrë në garën më të

SUPERLIGA - Java e 34-t

Të dielën takohen:
15:00 Gjilan - Drita
15:00 Ballkani - Llapi
15:00 Malisheva - Prishtina
15:00 Ferizaj - Trepça '89
15:00 Drenica - Dukagjini

“nxehtë”. Derbi i kësaj jave zhvillohet në mes të dy skuadrave nga qyteti i Gjilanit, Gjilanit dhe Dritës. Kjo e fundit kryeson tabelën dhe, me gjithë “arsenalin” e saj, do të kërkojë fitore në mënyrë që të bëjë hapin e madh në garën për titull të kampionit, edhe pse bardhekaltrit e Gjilanit nuk do ta kenë lehtë pasi ballafaqohen me rivalin e përbetuar, Gjilanin, i cili por kërkon një vend që dërgon në Evropë. Sfidë interesante dhe tejet e rëndësishme do të zhvillohet edhe në Suharekë, ku Ballkani,

që është në garë për titull me Dritën, e pret Llapi. Përballje e fortë parashikohet të luhet edhe në Malishevë, ku malishevasit e presin skuadrën e Prishtinës. Dukagjini, një tjetër skuadër që ende shpreson të sigurojë një vend që e dërgon në Evropë, kërkon pikët e plota në udhëtim te Drenica, e cila edhe matematikisht ka humbur garën për të mbetur në elitë, kurse sfida për mbijetesë luhet në Ferizaj, ku skuadra e Ferizajt e pret rivalin direkt për ekzistencë, Trepçën '89.

Loriana Kuka eliminohet në rrethin e parë

PRISHTINË, 12 PRILL - Kosova e ka mbyllur pa medalje pjesëmarrjen në Kampionatin Botëror të Xhudos, diçka që nuk i ndodh shpesh. Loriana Kuka ishte garuesja e shtatë dhe e fundit që zbriti të

premtën në tatami. Por, xhudistja pejane kishte përvojë të shkurtër në evenimentin që po mbahet në Doha të Katarit. Ajo u eliminua qysh në rrethin e parë të kategorisë deri në 78 kilogramë

nga garuesja bjelloruse, por që garon si e pavarur, Darya Kantsavaya. Pa medalje kanë mbetur edhe Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Erza Muminoviq, Flaka Loxha, Laura Fazliu dhe Akil Gjakova.



Arteta: Jemi të lumtur që e kemi Xhakën

Londër, 12 maj - Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, edhe një herë ka konfirmuar se ka besim të madh në mesfushorin shqiptar Granit Xhaka. Reprzentuesi shqiptar ka

kontratë me “Topçinjtë” deri në vitin 2024, por pritet të vazhdojë edhe më tej. “Nuk do t’u përgjigjem disa historive për Xhakën. Jam jashtëzakonisht i lumtur me Granitin. Ai po bën

një sezon të jashtëzakonshëm. Ky është ndoshta sezoni më i mirë që ai ka pasur në klub. Jemi vërtet të lumtur që e kemi”, ka thënë Arteta. Ditët e fundit nëpër medie të

huaja ka qarkulluar lajmi se Xhaka në verë do të largohet nga “Emirates” dhe do të transferohet në Bundesliga, të cilin e dëshiron Bayer Leverkuseni.



Haaland, futbollisti i vitit në Premierligë

MANCHESTER, 12 MAJ - Sulmuesi i Manchester Cityt, Erling Haaland, është shpallur futbollisti i vitit nga gazetarët anglezë për sezonin 2022-2023. Sensacioni norvegjez Haaland ka shijuar një sezon debutues historik te City, duke regjistruar 51 gola në të gjitha

garat. Prej tyre, 35 kanë ardhur në Premierligë, një rekord i ri për një sezon të vetëm në krye. FWA-ja ka thënë në faqen zyrtare të organizatës: "Haaland fitoi me një diferencë të madhe pas sezonit të tij të bujshëm debutues në Angli, duke shënuar 51 gola deri më tani

për Manchester Cityn. Për njëfarë kohe ai ishte në garë me Bukayo Sakan në votimin mes rreth 800 anëtarëve tanë, por përfundimisht fitoi nga pjesa më e madhe". Kapiteni i Arsenalit, Martin Odegaard, doli i treti në

sondazhin e meshkujve, me mesfushorin e Cityt, Kevin De Bruyne i katërti dhe sulmuesi i Manchester Unitedit, Marcus Rashford, i pesti. Haalandi do ta marrë çmimin e tij në një darkë speciale për Futbollistin e Vitit më 25 maj, e cila do ta shënojë 75-



vjetorin e çmimit të parë që iu nda Sir Stanley Matthews në vitin 1948.

Mourinho: Djemtë bënë maksimumin për të fituar. Alonso: Ne shkojmë në finale

Romë, 12 maj - AS Roma arriti një fitore magjike në "Stadio Olimpico", me rezultatin minimal 1 me 0, ndaj "aspirinave" të Bayer Leverkusenit në sfidën e parë të gjysmëfinaleve, të Ligës së Evropës. Trajneri Jose Mourinho është shprehur shumë i lumtur nga performanca e skuadrës së tij në fushën e lojës. "Është e gjitha meritë e djemve. Ata kanë një mentalitet, një dëshirë, një lidhje me tifozët, një ndjenjë përgjegjësie për të dhënë gjithçka dhe për t'i lumturuar tifozët. Sot nuk ishte një lojë e lehtë. intelektualisht ishte një ndeshje shumë e vështirë. Është e vështirë të luash kundër Leverkusenit, të qëndrosh i fokusuar për 90 minuta, të luash për të fituar dhe të kesh parasysh se humbja e topit mund të jetë shkatërruese. Djemtë bënë maksimumin për të fituar", ka thënë Mourinho.

Më tej, strategu portugez e lavdëroi edhe autorin e golit, Eduardo Bove. "Prindërit e Edos janë për t'u lavdëruar, jo unë. Ai është jashtëzakonisht i sjellshëm, i zgjuar, profesionist, sillet sikur të jetë 30 vjeç. Sezonin e kaluar ai hynte në fushë për pesë minuta në fund, këtë vit ka arritur në 30 minuta, madje



filloi disa ndeshje në fillim. Është detyra ime t'i ndihmoj lojtarët të rriten, por e di gjithashtu që për të qenë një person kaq i mirë, ai duhet të ketë një familje të mrekullueshme", ka shtuar Mourinho.

Pavarësisht prej humbjes nga Roma në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Ligës së Evropës, trajneri i Bayer Leverkusenit, Xabi Alonso, është optimist se klubi gjerman do të kualifikohet në finale. "Jemi të pakënaqur me rezultatin. Nuk donim të humbiste, por ne e dimë se javën e ardhshme do të kemi një

tjetër shans dhe e kuptojmë qartë se çfarë duhet të bëjmë. Duhet ta fitojmë ndeshjen. Nuk ka vend për gabime. Duhet të qëndrojmë të fokusuar", ka thënë Alonso. "Unë dhe Mourinho folëm. Ishte mirë të shiheshim pas gati 10 vjetësh. Prisja të përballesha me një ekip të fortë nga pikëpamja taktike. Pellegrini dhe Bove janë shumë të mirë. Në 10 minutat e para kemi pasur disa çaste të mira. Tani le të mendojmë për javën e ardhshme. Nuk ka humbur ende gjithçka. Ne do të përgatitemi për ndeshjen e ardhshme", ka shtuar Alonso.

Denveri kap finalet në Perëndim, Bostoni e Philadelphia shkojnë në ndeshjen e shtatë

BOSTON, 12 MAJ - Bostoni barazoi 3-3 serinë e ndeshjeve gjysmëfinale ndaj Philadelphia në Konferencën e Lindjes, pas fitores me rezultat 95-86 në takimin e gjashtë. Edhe pse Philadelphia luante në fushën e vet, nuk arriti ta shfrytëzojë këtë avantazh. Një ndeshje ku mbrojtja bëri dallimin, ku për Bostonin u dalluan Smarti me 22 pikë e Tatum me 19, ndërkohë që për Celticsin



Konferencën e Perëndimit, skuadra e Denverit bëhet ekipi i parë finalist, pas fitores me rezultat 125-100 në fushën e Phoenixit, duke fituar 4-2 serinë. Një ndeshje pa histori, e dominuar nga miqtë, që e merituan fitoren e kualifikimit. Tjetër ndeshje e mirë

për Nikola Jokiqin, që realizoi sërish "triple double", me 32 pikë, 10 rebounde e 12 asistime, mbështetur nga Murray me 26 pikë e Pope me 21 pikë. Për Phoenixin, Payne realizoi 31 pikë e Duranti 23, ndërkohë që zhgënjeu Booker.

Konferenca e Lindjes, "Play-off" - Gjysmëfinale	
Boston - Philadelphia	95-86 (3-3)
New York - Miami	(2-3)
Konferenca e Perëndimit, "Play-off" - Gjysmëfinale	
Denver - Phoenix	125-100 (4-2)
Golden State - Lakers	(2-3)

luajtën vetëm 7 lojtarë. Për Philadelphia, Embiid e Maxey realizuan nga 26 pikë secili, por që s'mjaftuan për të fituar e shkuan në finalet "play-off" në Lindje. Në

Allegri: Barazimi i merituar ndaj Sevilas

Juventus mori një barazim në sekondat e fundit ndaj Sevilas në Ligën e Evropës duke mbajtur hapur shpresat për kualifikim. Trajneri Massimiliano Allegri fajësoi Bonuccin për golin e pësuar,

ndërkohë që vlerësoi kundërshtarët si ekspertë në këtë kompeticion. "Bëmë një ndeshje të mirë derisa pësua golin, ndërsa në pjesën e dytë bëmë një lojë akoma më të mirë. Barazimi

ishte një rezultat i merituar dhe tashmë lë çështjen e kualifikimit të hapur. Kur arrin në një nivel të ndeshjeve gjysmëfinale, ekipet janë të barabarta. Sevilla është një ekip ekspertësh që nuk e lë

kurrë lojën dhe e dëshmuar përsëri. Ne duhej të ishim më të saktë në 25 minutat e para", ka thënë Allegri. "Goli i pësuar. Di Maria duhet të kishte luajtur aty një top më të thjeshtë. Bonucci kaloi nën

presion të lartë. Ai duhet të bënte një faull vetëm të mos shënohej gol. Sevilla ishte e përgatitur në nisjen e kundërsulmit, por ne ishim gjithashtu në pozicion", ka shtuar Allegri.

SHKURT

UEFA: Finalja e Ligës së Kampionëve zhvillohet në Stamboll

Finalja e Ligës së Kampionëve do të zhvillohet në Stamboll. U aludua shumë që edhe këtë vit do të mund të zhvendoset finalja e kompeticionit më të madh në nivel klubesh, Ligës së Kampionëve. Sipas medieve të huaja, UEFA bëri një qasje jozyrtare ndaj Federatës Portugeze për transferimin e finales në Lisbonë nëse ka trazira në Stamboll pas zgjedhjeve presidenciale turke. Por, një gjë të tillë ka mohuar shtëpia më e madhe e futbollit, UEFA. "Finalja e Ligës së Kampionëve të UEFA-s 2023 do të zhvillohet në Stamboll siç ishte planifikuar", thuhet në deklaratën e saj. Finalja e këtij viti mbahet më 10 qershor, dhe ndeshja do jetë në mes fituesit të ndeshjeve Real Madrid - Manchester City dhe Inter - Milan.

Presidenti i Napolit: I largova të gjithë lojtarët që luanin pa motiv dhe nuk më jepnin atë që dëshiroja, titullin

Presidenti i Napoli, Aurelio de Laurentiis, në një intervistë për "La Repubblica", ka rrëfyer se fitimi i titullit kampion në Serinë A është një punë që nuk erdhi pas vetëm një sezoni. Ai konfirmon se ky mision ka nisur prej vitesh, që kur ekipin e drejtonte Carlo Ancelotti, për të ardhur te sukcesi i madh. "Me Ancelottin dhe Gattuson ndodhën disa gjëra që nuk më pëlqyen, që nuk më bindnin. Ndaj, më në fund arrita t'i heq qafe të gjithë lojtarët që ishin të pamotivuar dhe që nuk mund të më jepnin atë që dëshiroja, titullin", u shpreh De Laurentiis. "Ndjeva se kisha nevojë për një frymë të re dhe dalëngadalë ndërtaam ekipin e këtij sezoni. Giovanni Di Lorenzo është një kapiten i mrekullueshëm, mbi të cilin mund të vësh gjithnjë bast. Është një udhërrëfyes për skuadrën, të gjithë duhet ta studiojnë, pasi nga ai ka gjithnjë se çfarë të mësohet", ka shtuar De Laurentiis.

Klopp: Liverpooli është tërheqës për lojtarët edhe pa Ligë të Kampionëve

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, është i bindur se dyshimet rreth kualifikimit në Ligën e Kampionëve nuk do t'i dëmtojnë planet e tyre në tregun e transferimeve. "Reds" aktualisht është në vendin e pestë dhe shkon në Leicester City të hënën në mbrëmje, në ndeshjen e javës së 36-të. Ekipi nga "Anfield" pret gabime nga Manchester Unitedi dhe Newcastle për t'u kualifikuar në Ligën e Kampionëve, por Kloppi mendon se "Reds" është tërheqës për lojtarët edhe nëse nuk kualifikohet në garën elitare për klube. "Kur flas me një lojtar, nëse më lejohet të flas me një lojtar, nuk mund të themi për momentin nëse kemi futboll në Ligën e Kampionëve. Pra, nëse tashmë po flasim, atëherë është e qartë se ai tashmë e di për atë situatë", ka thënë Klopp. "Por, kjo është vetëm një gjë e përgjithshme. Unë mendoj se nëse i bashkohesh një klubi, do të arrish diçka së bashku me klubin. Është e qartë se ne duhet të jemi pjesë e Ligës së Kampionëve, të luftojmë për trofe dhe gjëra të tilla. Nëse doni të jeni pjesë e kësaj, ju jeni më se të mirëpritur. Ne nuk mund të garantojmë këtë vit futbollin e Ligës së Kampionëve". "Por, gjithçka tjetër është njësoj si më parë: një klub fantastik me një ekip futbollit vërtet të mirë - dhe një më i mirë shpresojmë vitin e ardhshëm. Është vërtet kaq e thjeshtë. Ende Liverpool. Ne jemi vërtet tërheqës për shumë lojtarë", ka deklaruar Klopp.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PËRPARIMI SH.A - VUSHTRRI
Nr: Protokolli: 545/23
Data: 12.05.23

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 4 dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A, lidhur me nenin 16 nën par. 1.8.3 dhe 1.12.5 të Rregullores Nr. 35/23 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. 537/23 të datës 11.05.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A me datë 12.05.2023 shpall:

KONKURS PUBLIK

1. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes-Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve

Koeficienti i pagës: 3.9

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes-Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është nën hetime dhe të sillet në formë origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj);
- Dëshmitë për përvojën e punës (Nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit;

2. Titulli: Elektricitist

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv

Koeficienti i pagës: Sipas aktit të brendshëm të ndërmarrjes

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Është përgjegjës për punët që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e ndriçimit publik.
- Zbaton detyrat dhe aktivitetet operative të përcaktuara nga udhëheqësi i tij.
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e ndriçimit, si dhe punët tjera të elektrikes në ndërmarrje.
- Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar, si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të NPL.
- Për punën e vet i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Logjistikës.
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Kushtet e veçanta

- Trajtime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë aftësi të mira kompjuterike.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata në lidhje me të kaluarën kriminale e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë (6) muaj.
- Dëshmitë për përvojën e punës nëse ka;
- Kopjen e letërnjoftimit;

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 15.05.2023 deri me datë 29.05.2023 në ora 16:00.

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr.tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



U skladu sa članom 8, članom 10 stavom 2.2, članom 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenom u Službenom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010, u vezi s članom 4 i članom 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o uređivanju postupka konkursa u javnom sektoru, koji je dio Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017, članom 8 stavom 4, članom 11, članom 21 stavom 2.2 i članom 25 Pravilnika br. 55/21 o radnom odnosu N.P.L. "Përparimi" Sh. A. u Vushtrri, u vezi sa članom 16 stavom 1.8.3 i 1.12.5 Pravilnika br. 35/23 o internom organizovanju i sistematizaciji radnih mjesta u NPL "Përparimi" Sh.A, i uzimajući u obzir odluku broj 537/23 od 11.05.2023. godine od strane Izvršnog direktora, NPL "Përparimi" Sh.A, dana 12.05.2023. godine objavljuje se:

JAVNI KONKURS

1. Naslov: Čistač kancelarija i objekat

Broj izvršilaca: 1

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja

Stručna priprema: Osnovna škola

Radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo

Izvještava: Rukovodioci jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata

Koeficijent plate: 3.9.

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upućen od pretpostavljenog;
- Pridržavaće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i druge obaveze vezane za radno mesto a na osnovu zahteva pretpostavljenog
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Uz prijavu se mora priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za N.P.L. „Përparimi“ Š. A.;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma mora biti ovjerena);
- Izvod iz matične knjige rođenih (mora biti original);
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i mora se doneti u originalu (ne starije od 6 meseci);
- Dokaz o radnom iskustvu (ako postoji, nije obavezan);
- Kopija lične karte;

2. Naslov: Električar

Broj izvršitelja: 1

Radni sati: 40 sati sedmično

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.

Stručna sprema: Srednja škola

Radno iskustvo: Poželjno jedan (1) godine

Izvještava: Izvršni direktor

Koeficijent plaće: Prema internom aktu preduzeća

Opis zaduženja i odgovornosti posla:

- Opis poslova i odgovornosti:
- Odgovoran je za poslove održavanja javne rasvete.
- Izvršava zadatke i operativne aktivnosti koje su mu određene od strane svog rukovodioca.
- Odgovoran je za održavanje rasvete, kao i drugih elektrotehničkih poslova u preduzeću.
- Odgovoran je za potrošeni materijal i beleži troškove materijala u odgovarajuće dokumente prema NPL dokumentaciji.
- Odgovoran je svom rukovodiocu u jedinici za logistiku.

Posebni uslovi:

- Dodatna obuka tokom karijere;
- Dobre komunikacione veštine;
- Dobre računarske veštine.

Aplikaciji mora da priloži:

- Formular za prijavu N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vučitrn;
- Dokaz o kvalifikaciji školovanja (diploma se dostavlja ovjerena);
- Izvod iz matične knjige rođenih (mora biti original);
- Uvjerenje suda o krivičnoj prošlosti koje ne smije biti starije od šest (6) meseci;
- Dokaz o radnom iskustvu, ako postoji;
- Kopiju lične karte.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu uzeti i predati prijavni formular u kancelariji Arhiva N.P.L. „Pëparimi“ Š. A u gradu Vučitrnu, ul. „Gjergj Kastriot Skenderbeu“ br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 15.05.2023 do 29.05.2023 u 16:00 časova.

N.P.L "Pëparimi" Š. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Avdyl Maroshi Damjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f. "Hamez Cena " Damjan KK Gjakovë.

- Ardit Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Madan Construction” SH.P.K. Pronar Ramadan Mehmeti me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811871046 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Madan Construction” D.O.O. Ramadan Mehmeti Gnjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811871046 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Madan Construction” L.L.C. with headquarters Ramadan Mehmeti Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811871046 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Hemet Group” SH.P.K. pronar Mehmet Mehmeti me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811870577 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Hemet Group” D.O.O. Mehmet Mehmeti Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811870577 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Hemet Group” L.L.C. with headquarters Mehmet Mehmeti Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811870577 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Gerta” SH.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 8109750131 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gerta” D.O.O. od Prizrena, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810975013 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Gerta” L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 810975013 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania N.P.T. “Gimi” Gjonaj, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektin montazhë për riciklimin e mbeturinave të ngurta inerte sipas kodeve 17; 17 01; 17 01 01; 17 01 02; 17 01 03; 17 01 04; 17 01 05; 17 02; 17 02 01; 17 02 03; 17 04; 17 04 05; 17 04 08; 17 05 04; 17 06; 17 07; 17 07 03; 17 03 01; 20 01 02; 20 01 04 20 01 05, në Dushanovë, Komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 23.06.2023 në ora 10:00 në Shkollën Sh.F.M.U “Ibrahim Fehmiu” Arbanë-Prizren do të organizohet debat publik nga kompania N.P.T. “Gimi” Gjonaj, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë N.P.T. “Gimi” Gjonaj, Prizren për objektin montazhë për riciklimin e mbeturinave të ngurta inerte sipas kodeve 17; 17 01; 17 01 01; 17 01 02; 17 01 03; 17 01 04; 17 01 05; 17 02; 17 02 01; 17 02 03; 17 04; 17 04 05; 17 04 08; 17 05 04; 17 06; 17 07; 17 07 03; 17 03 01; 20 01 02; 20 01 04 20 01 05, në Dushanovë, Komuna e Prizrenit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



CONTRACT AWARD NOTICE SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 12/05/2023

Procurement No	Platforma	002	2022	221
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone: 044-128-277	
Email: zefshala@hotmail.com	Fax: 038-542-865	
Internet address (if applicable):	www.matherteresasociety.org	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:

Digital Platforma-Webside for 11 BMO-s

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance

(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

Services

Main place of performance
All Kosovo according to the
Request of Contracting
Authorities

II.1.4) Short description of the object of the contract

Digital Platforma-Webside for 11 BMO-s

II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

93.000.000.-8

II.1.6) Division into lots

Yes

II.1.7) Contract value: Lot 1 12,000.00 Euro

Lot 2 10,000.00 Euro

In Total Lot1+Lot2 =22,000.00 Euro

SECTION III: PROCEDURE

III.1) TYPE OF PROCEDURE

Open

III.2) AWARD CRITERIA

Lowest Price

III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award 12/05/2023		
IV.2) Intended date of contract signing 18/05/2023		
IV.3) Number of received tenders 5		
IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded		
Official name: Smart Inovation Centre Str. Agim Ramadani Prishtinë		
Postal address: 10000 Prishtinë		
Town: Prishtinë	Postal code: 10000	Country: Kosovo
URL (if applicable):		
Contact point(s): Lirie Namani	Email: info@sic-ks.com	
Telephone: +383 45/817-477 Mobil	Fax: +383-38-748-701	

IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract 22,000.00 Euro

Responsive tender with lowest price: 22,000.00 Euro

Responsive tender with highest price: 27,500.00 Euro

IV.6) The contract is likely to be subcontracted

No

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract award notice.



CONTRACT AWARD NOTICE SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 11/05/2023

Procurement No	Mentoring	002	2023	221
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone: 044-128-277	
Email: zefshala@hotmail.com	Fax: 038-542-865	
Internet address (if applicable):	www.matherteresasociety.org	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:

Individual consultancy-Mentoring and Coaching for 150 women beneficiaries

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance

(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

Services

Main place of performance
All Kosovo according to the
Request of Contracting
Authorities

II.1.4) Short description of the object of the contract

Individual consultancy-Mentoring and Coaching for 150 women beneficiaries

II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

93.000.000.-8

II.1.6) Division into lots

NO

II.1.7) Contract value: 45,500.00 Euro

SECTION III: PROCEDURE

III.1) TYPE OF PROCEDURE

Open

III.2) AWARD CRITERIA

Lowest Price

III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award 11/05/2023		
IV.2) Intended date of contract signing 18/05/2023		
IV.3) Number of received tenders 5		
IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded		
Official name: "SMART INOVATION CENTRE"-SIC Str. Agim Ramadani A3 Prishtinë		
Postal address: 10000 Prishtinë		
Town: Prishtinë	Postal code: 10000	Country: Kosovo
URL (if applicable):		
Contact point(s): Saranda Lajqi	Email: info@sic-kos.com	
Telephone: +383 44/45 817477	Fax: +38338748701	

IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract 45,500.00 Euro

Responsive tender with lowest price: 45,500.00 Euro

Responsive tender with highest price: 60,000.00 Euro

IV.6) The contract is likely to be subcontracted

No

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract award notice.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Departamenti për Burime Njerëzore



07/1-01 SAP-R/519/2023
Datë 12.05.2023

Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 18/04/2023 me nr ref: DBN 07/025/2023, Policia e Kosovës:

VAZHDON AFATIN E KONKURISIT

Të publikuar nga data 19.04.2023 deri me datë 12.05.2023 me nr reference 07/1-01 SAP-R/516/2023 për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të gjitha minoritetet (Serb, Boshnjak, Turq, Goran, Romë, Ashkali, Egjiptas, Kroat, Malazez, Maqedonas).

Titulli i vendit të punës: Zyrtar Policor

Vendi i punës : Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri

Afati për paraqitjen e aplikacioneve vazhdohet për tetëmbëdhjetë (18) ditë duke filluar nga data

13.05.2023 deri me datë **30.05.2023**.

Vëmendje: Kriteret në konkurs mbeten të njëjta si dhe kandidatët të cilët kanë konkurruar në këtë konkurs nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.

Formularët për aplikim mund të merren në zyrat e personelit të drejtorive rajonale, në stacionet policore, ose të tërhiqen nga ueb faqja e PK-së: www.kosovopolic.com. Aplikacioni për konkurrim duhet të dorëzohet së bashku me kopjet e dëshmimeve të kërkuara personalisht në zyrën e personelit pranë drejtorive rajonale në Prishtinë, Mitrovicë Jug, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë Veri dhe Gjakovë, çdo ditë pune prej **orës 09:00-15:00**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Uprava za Ljudske Izvore



07/1-01 SAP-R/519/2023
Datë 12.05.2023

Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o radu br. 03/L-212, poglavlje II, član 8, Zakon o ravnopravnosti polova br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakona o zaštiti od diskriminacije Br. 05/L-021, član 7, Administrativno Uputstvo 01/2021 o Radnom Odnosu u Policiji Kosova, poglavlje III član 8, član 9, tačka 1 i 2, i usvajanjem Generalnog Direktora od 18/04/2023 pod br ref: DBN 07/025/2023, Policia Kosova:

PRODUŽENJE ROKA KONKURSA

Objavljen od 19.04.2023 do 12.05.2023.godine, sa br. referencije 07/1-01 SAP-R/516/2023 za prijem policijskih službenika po prethodnim uslovima konkursa za sve manjine (Srbe, Bošnjake, Turaka, Goranaca, Roma, Aškalije, Egipćane, Hrvate, Crnogorce, i Makedonce).

Naziv radnog mesta: Policijski službenik

Radno mesto: Regionalna Direkcija Mitrovica -Sever

Rok za prijavu aplikacija produžava se za osamnaest (18) dana, počev od **13.05.2023. do 30.05.2023.** godine.

Pažnja: Kriterijumi na konkursu ostaju isti, i kandidati koji su konkurisali na ovom konkursu ne moraju da se ponovo prijave .

Formulare za apliciranje mogu se uzeti u kancelarijama osoblja Regionalnih Direkcija, u Stanicama Policije, ili da se preuzimaju iz ueb stranice PK-a: www.kosovopolic.com. Aplikacija za konkurisanje treba da se preda lično zajedno sa kopijama potrebnih dokaza u kancelariji osoblja Regionalne Direkcije Priština, Mitrovica Jug, Peć, Prizren, Uroševac, Gnjilane, Mitrovica Sever i Djakovica, svakog radnog dana od **09:00-15:00.časova**.

